



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Zyra për Komunikim me Publikun
Kancelarija za Javno Komuniciranje
Office of Public Communication

THIRRJE PËR APLIKIM

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural fton te gjithë fermerët e interesuar qe te aplikojnë per mbështetje përmes Programit per Pagesa Direkte per vitin 2020

Përkrahja jepet për këto kultura dhe aktivitete bujqësore:

Pagesat Direkte për sipërfaqet e mbjellura të grurit
Pagesat Direkte për sipërfaqet e mbjellura të fares se grurit
Pagesat Direkte për sipërfaqet e mbjellura të elbit
Pagesat Direkte për sipërfaqet e mbjellura të thekres
Pagesat Direkte për sipërfaqet e mbjellura të tërshërës
Pagesat Direkte për sipërfaqet e mbjellura të misrit
Pagesat Direkte për sipërfaqet e mbjellura të lulediellit
Pagesat Direkte për vreshtat ekzistuese
Pagesat Direkte për verë te prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht
Pagesat Direkte për pemishtet ekzistuese
Pagesat Direkte për sasinë e dorezuar/ shitur te frutave te mjedrës
Pagesat Direkte për prodhimtarinë e materialit fidanor te pemëve drufrutore dhe hardhisë se rrushit mbi nënshartesat vegetative
Pagesat Direkte për sipërfaqet e mbjellura me perime
Pagesat Direkte për prodhimtari organike
Pagesat Direkte për bimë mjekësore dhe aromatike
Pagesat Direkte për lopë dhe buallica qumështore
Pagesat Direkte për dele qumështore
Pagesat Direkte për dhi qumështore

Pagesat Direkte për qumësht sipas kategorive të cilësisë për gjashtëmujorin e parë 2020
Pagesat Direkte për therrjet e raportuara të gjedhit për gjashtëmujorin e parë 2020
Pagesat Direkte për sektorin e akuakulturës
Pagesat Direkte për bletë
Pagesat Direkte për pula vojse
Pagesat Direkte për thëllëza
Pagesat Direkte për dosat për riprodhim
Pagesat Direkte për primin e sigurimit bujqësor për kulturen bujqësore të mjedrës, mollës, kumbullës, rrushit, dredhëzes dhe specit

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjat 25 ditë kalendarike dhe fillon nga dita e shpalljes publike, nga data 20.07.2020 dhe përfundon me datë 14.08.2020

Menyra e aplikimit:

Aplikimi bëhet në zyrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi
Në rastet kur fermeret aplikojnë për disa kultura apo aktivitete bujqësore, plotësohet dhe dorëzohet vetëm një aplikacion.

Sqarim:

Gjate kontrollit në terren, në rast të gjetjes së parregullsive, do të aplikohen masa ndëshkimore duke u bazuar në Udhezimin Administrativ për Pagesa Direkte në Bujqësi për vitin 2020
Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje dhe brenda periudhës së aplikimit.
Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar dhe i përkryer, nuk do të pranohet për shqyrtim

Informatat:

Për kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, informatat e hollësishme mund të merren në web faqen e MBPZHR-së, www.mbpzhr-ks.net dhe në web faqen e AZHB-së, www.azhb-ks.net, si dhe në Drejtoritë Komunale për Bujqësi.